



**Wisner: Shtetet e Bashkuara krenare të mbështesin bujqësinë e qëndrueshme në Shqipëri**

Faqe 3



**Dikur emigrantë sot eksportues, historia e vëllezërve Aleksandër e Tomorr Dulaj nga Portëza e Fierit**

Faqe 5



**Siguria ushqimore, MBZHR dhe BB, investojnë në laboratorë në pikat kufitare për produktet e importit**

Faqe 2



# AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit dhjetor 2023

**Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 476**  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# BIZNESET KËRKOJNË FUQI PUNËTORE CILËSORE DHE TË RINJTË QË KËRKOJNË PUNË PREZANTOHET STUDIMI "DREJT RRITJES SË NUMRIT DHE CILËSISË SË VENDEVE TË PUNËS NË SHQIPËRI"

*Konferenca e organizuar nga RisiAlbania bëri bashkë panelistë nga administrata publike, përfaqësues të biznesit dhe organizata ndërkombëtare që synuan të zbërthejnë dhe reflektojnë mbi hapat konkretë se si të hapen urat ndërmjet kërkimit të bizneseve për fuqi punëtore të kualifikuar dhe kërkesës së të rinjve për punë cilësore*

**Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe Redaksia e Gazetës "Agrobiznesi" ju Uron Gëzuar Vitin e Ri 2024 dhe Mbarësi në familjet tuaja!**

**RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC**

**Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, "Green Branding dhe Pozicionimi për Bizneset Shqiptare të Turizmit"**



**Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri**

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



**Denaj me drejtorin e UNIDO-s, diskutojnë për strategjinë e zhvillimit industrial të Shqipërisë**



Faqe 2

## FINANCIM

**"Dëftesat tregtare", garancia e fermerëve për kreditim - Skema se si do funksionojë. "Shteti të marrë përsipër kostot nëse produkti dëmtohet"**



Faqe 6

## FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE



**"Nga artet dhe zanatet në produkte dizajni", panairi kushtuar fuqizimit ekonomik të grave**

Faqe 5

## TEMA TË DITËS

- Të rinjtë drejt arsimit profesional, transferim nga gjimnazi në shkollat profesionale Fq.2
- Mbështetje nga Skema Kombëtare, vëllezërit Tatani në Kavajë ndërtuan stallën me 250 gjedhë Fq.5
- BERZH mbështet projektin për klimën dhe zhvillimin e bujqësisë Fq.6
- Në shkollën profesionale "Rakip Kryeziu" në Fier, të rinjtë orientohen në zanatet e biznesit bujqësor e blegtoral Fq.4

## RISI ALBANIA

# Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, “Green Branding dhe Pozicionimi për Bizneset Shqiptare të Turizmit”

Në serinë e webinarëve mbi turizmin e qëndrueshëm, të enjten e 14 dhjetorit me profesor Mirdaim Axhami, u diskutua mbi “Green Branding dhe Pozicionimin për Bizneset Shqiptare të Turizmit”.

Kjo seri webinarësh organizohet me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Helvetas, Partners Albania for Change and Development

Subjekte dhe aktorë që operojnë në sektorin e Turizmit, patën mundësinë të njihen dhe shkëmbejnë eksperiencat e tyre në këtë sektor, duke rritur njohuritë në turizmin e qëndrueshëm dhe duke krijuar lidhje të reja biznesi.

Profesor Axhami gjatë fjalës së tij u ndal në “Markën e gjelbër” një emër, term, dizajn ose simbol që identifikon produktet në shitje dhe i dallon ato nga produktet e konkurrentëve.

“Bizneset, kohët e fundit, tha Axhami, janë shumë të përqendruara në markimin sepse në nivelin e produktit-treg, kapitali i markës rrit efektivitetin e kanalit dhe komunikimin dhe ul ndjeshmërinë ndaj çmimit të lidhur me markën. Markat e gjelbra janë ato marka që konsumatorët i lidhin me ruajtjen e mjedisit dhe praktikën e qëndrueshme të biznesit. Marka të tilla apelojnë për konsumatorët që po ndërgjegjësohen më shumë për nevojën për të mbrojtur mjedisin. Një markë e gjelbër mund të shtojë një pikë unike në tërheqjen e vizitorit dhe mund të rrisë imazhin e biznesit. Objektivi i takimit të sotëm është prezantimi i strategjive të ndryshme të markës së gjelbër të adoptuara nga firmat e biznesit në mënyrë

që të pozicionojnë produktet e tyre miqësore me mjedisin në tregun e gjelbër, që gjenerojnë zhvillim të qëndrueshëm të turizmit”, u shpreh profesori. Sipas tij, konceptet e biznesit të gjelbër, produkteve të gjelbërta, markës së gjelbër dhe strategjive të markës së gjelbër janë markat më të mira që i rezistojnë kohës dhe zhvillimit.

Duke e sjellë këtë koncept të rëndësishëm në sektorin e turizmit, ai tha se, idetë e biznesit

e marketingut të gjelbër. “Firmat e biznesit të gjelbër duhet të zbatojnë strategjitë e markës së gjelbër, për të zënë një hapësirë në mendjet e konsumatorëve miqësorë me mjedisin që nxisin zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në vendin tonë”, tha Axhami.

Por ndërkohë a janë bizneset turistike shqiptare të orientuara drejt shërbimit të klientëve ndërkombëtarë?

Bukuria e natyrës së Shqipërisë akoma e pazbuluar për



Tema:  
Green Branding dhe Pozicionimi për Bizneset Shqiptare të Turizmit

MIRDAIM AXHAMI

14 Dhjetor 2023 | Ora 17:00

Sustainable Tourism  
Webinar Series

#sustainabletourism  
#webinarseries

HOCHSCHULE  
LUZERN

të gjelbër, produkteve të gjelbra, markës së gjelbër dhe strategjive të markës së gjelbër, proceseve ekologjike, janë ato të duhet të shoqërojnë zhvillimin e biznesit në çdo sektor të ekonomisë dhe specifikuat në atë të turizmit.

Studimet kanë treguar se firmat e biznesit të gjelbër ekskluzivisht menaxherët e markave jeshile duhet të ndryshojnë mendjen, nga strategjitë e marketingut tradicional në strategjitë

shumë vizitorë ndërkombëtarë, po reklamohet gjithnjë e më shumë si për bukuritë e mahnitshme natyrore, po ashtu edhe për shumëllojshmërinë e vendeve që ofron për t'u eksploruar. Kombinimi i detit, lumenjve dhe maleve krijon një përvojë vërtet të mrekullueshme për vizitorët.

Kohët e fundit, prezenca e pamjeve të mrekullueshme të Shqipërisë është rritur përmes

(Vijon në faqen 3)

## Të rinjtë drejt arsimit profesional, transferim nga gjimnazi në shkollat profesionale

Zgjedhja e Irsës në nisje të vitit shkollor ishte gjimnazi, por pas 2 dy muajsh arriti të kuptonte se kishte gabuar dhe se nuk kishte vepruar drejt. Gjithmonë kishte ëndërruar të vijonte studimet për biznes ndaj në nisje të rrugëtimit të saj ndryshoi drejtim dhe u regjistrua në shkollën profesionale ekonomike.

Irsa arriti të transferohet në një shkollë profesionale shumë shpejt nëpërmjet platformës e-Albania

Nxënësit e klasave të 10-ta që sapo kanë nisur gjimnazin dhe shohin si zgjidhje arsimin profesional mund të transferohen brenda 3-mujorit të parë në 28 shkollat profesionale në

vend.

Për shkak të nevojës që ka tregu i punës për profesionist Ministria e Arsimit në nisje të këtij vitit shkollor ka inici-

uar fushatën “Zgjidh Zanatin“, që synon transferimin e gjimnazistëve në muajt e parë në shkollat profesionale pa burokraci.



## Denaj me drejtorin e UNIDO-s, diskutojnë për strategjinë e zhvillimit industrial të Shqipërisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u takua me drejtorin e përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO), Gerd Muller.

Takimi u mbajt në kuadër të punimeve të konferencës ndërkombëtare të organizuar nga UNIDO në Vjenë, mbi industrializimin në vendet me të ardhura të mesme.

“Diskutuam së bashku për ekspertizën që mund të ofrojë UNIDO për strategjinë e zhvillimit industrial të Shqipërisë, veçanërisht për sektorët prioritarë si agrobiznesi dhe mbështetja e rrugës drejt integritimit në BE”, u shpreh Denaj.

Takimi ministror i “Grupit

me mendje të njëjtë për vendet me të ardhura të mesme”

Aktualisht i përbërë nga 108 vende, MIC-të janë një



u mbajt në kuadër të sesionit të 78-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

grup i larmishëm që përbën 30 % të prodhimit të brendshëm bruto global (PBB) dhe 75 % të popullsisë së botës.

## Siguria ushqimore, MBZHR dhe BB, investojnë në laboratorë në pikat kufitare për produktet e importit

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj tha se, “në mesin e muajit dhjetor, pritet të aprovohet një marrëveshje në Parlament me Bankën Botërore, në shumën 20 milionë euro, që shkon në laboratorë vetëm në pikat kufitare, për kontrollin e produkteve të importeve”.

Gjatë një interviste televizive,

se eksportet”, tha Denaj. “Unë mendoj se ky eksporti i brendshëm do jetë një zhvillim eksponencial paralelisht me eksportet. Ajo që duhet është, në radhë të parë të ruajmë tokën, mos të na e marrë uji, shiu, të ruajmë produktet nga breshëri. Kushtet klimatike janë kërcënim më absolut që na vjen, jo vetëm për Shqipërinë, sidomos

masat, mbështetëse në këto pesë vitet e fundit e kanë transformuar ekonominë bujqësore dhe kanë sjellë një rezultat shumë pozitiv”.

“Ne kemi rritur eksportet me 3.5 herë dhe nuk mund të rritet kjo me skemat kombëtare. Eksportet me 3.5 herë nuk mund të rriteshin nëse nuk do të ishte mbështetja e IPARD II. Ne do të presim drejtësinë të flasë. Në perspektivën e shifrave vendosa përkrah të cilave kanë realizuar 500 kontratat e kontraktuara. Gati 85 milionë euro të kontraktuara dhe 63 milionë të disbursuara janë aty, janë kontrata që prodhojnë këtë konsiderim të eksportit në 3.5 herë në rritje. Duhet të ndajmë dy elementë, njëri element që do të jetë subjekt i drejtësisë dhe vetëm kur të flasë për të gjithë terminologjinë që përdoret, si përfaqësuese e një institucioni që ka marrë detyra për një proces që e mban ‘on hold’ dhe nuk është pezullim, është lënie në pritje. E njëjta terminologji përdoret edhe në progres raport, që komisioneri, nëpërmjet drejtorisë së bujqësisë të KE, ka adresuar lënie në pritje për IPARD 3, i cili ka 9 nëntë programe, kërkon një institucion zbatues më të fortë, që të mësojë nga gabimet në IPARD 2 dhe të bëhet gati për 3-shin. Ne jemi në një plan pune që do ta dorëzojmë në dhjetor në këtë organizatë dhe këtë ndryshim që pritet ta realizojmë nëpërmjet masave që do të marrim së brendshmi do të duhet të na e certifikojnë për të vijuar më tej me akreditimin e nëntë nënprogrameve të IPARD 3”, tha Denaj.



Denaj, u ndal në hapat që ka hedhur zhvillimi i agroturizmit.

“Një format tjetër bashkëpunimi është ndërlidhja e prodhimit bujqësor me turizmin, në atë që quhet agroturizëm. Ne kemi shembur shumë të mirë në Fishtë, ku ka qenë frymëzim edhe për agroturizme të tjera. Kemi vlerësuar që në mesatare, në Shqipëri, një agroturizëm në kapacitetet më të ulëta të tij, bashkëpunon me 20 fermerë të zonës, 20 familje që sjellin produkte. Vetëm për këtë vit, që ne na ardhën mbi 8 milionë turistë, presim 10 milionë, nuk e di nëse e kapim këtë vit, ne kemi prodhuar në Shqipëri për konsumatorin vendas dhe të huaj, 1.5 herë më shumë

breshëri, për sigurinë ushqimore”, theksoi ajo

Ministrja u shpreh se, bashkimi i operatorëve i duhet fermerëve dhe për këtë MBZHR ka ftuar dhe pushtetin vendor të jetë pjesëmarrës në këtë nisim.

Denaj tha se, qeveria mbetet e angazhuar të mbështesë fermerët dhe zhvillimin e bujqësisë në të gjitha drejtimet.

Ajo informoi se, vitin që vjen do të mbështeten jo vetëm tregjet në qytete, por edhe tregjet që janë tradicionale, për t'i kthyer në qendra atraksione turistike, përveç se marrëdhënies biznes me biznes.

Në lidhje me programin IPARD, Denaj tha se, “fondet e programit IPARD, me katër

## KONFERENCA

BIZNESET QË KËRKOJNË FUQI PUNËTORE CILËSORE DHE TË RINJTË QË KËRKOJNË PUNË CILËSORE

## PREZANTOHET STUDIMI "DREJT RRITJES SË NUMRIT DHE CILËSISË SË VENDEVE TË PUNËS NË SHQIPËRI"

Konferenca e organizuar nga RisiAlbania bëri bashkë panelistë nga administrata publike, përfaqësues të biznesit dhe organizata ndërkombëtare që synuan të zbërthejnë dhe reflektojnë mbi hapat konkretë se si të hapen urat ndërmjet kërkimit të bizneseve për fuqi punëtoare të kualifikuara dhe kërkesës së të rinjve për punë cilësore

Deri para pak kohësh flisnim vetëm për punësimin dhe veçanërisht për punësimin në Shqipëri. Tani, ia dolëm ta zhvendosim debatin publik nga punësimi në punë të denjë, ishte një nga pikat kryesore të eventit: "Bizneset që kërkojnë fuqi punëtoare cilësore dhe të rinjtë kërkojnë punë cilësore".

Ngjarja, e parashikuar si

ve, diskutimet u drejtuan për atë që bizneset mund të nisin vetë që të ofrojnë kushte më të mira për punonjësit e tyre, pavarësisht disa sfidave. Në këtë këndvështrim, Mediteranea shpk, fabrika e tekstilit në Shqipëri prezantoi praktikën e saj të ofrimit të shërbimeve të Kujdesit për Fëmijët në vendin e punës, për të mbështetur gratë dhe nënat e reja të integrohen në tregun e punës.

dimensione: punësimin, mbrojtjen sociale, dialogun social dhe të drejtat në punë.

Në qendër të diskutimeve ishte studimi "Drejt rritjes së numrit dhe cilësisë së vendeve të punës në Shqipëri" që RisiAlbania ka bërë në bashkëpunim me një ekip konsulentësh duke përdorur metodën e ILO-s.

Ky studim shërbeu për të: 1) Identifikuar aspektet përkatëse të cilësisë së punës për të rinjtë e punësuar aktualisht, ose me gjasë për t'u punësuar në vende pune në sektorët e agrobiznesit, turizmit dhe ICT-së. 2) Mundësuar një analizë të mangësive të punës së denjë dhe mundësive, referuar standardeve të ONP-së dhe synimeve e aspiratave të të rinjve në Shqipëri, si dhe për të identifikuar masat e mundshme për trajtimin e mangësive.

U krye një proces kërkimor dhe analitik, i cili rezultoi në këtë Raport Përfundimtar, që:

- Paraqet një analizë krahasuese mangësish për të përshkruar situatën me të cilën përballen të rinjtë në çdo sektor, duke shërbyer si një 'bazë fillestare' kundrejt së cilës mund të maten përmirësimet e ardhshme.

- Përshkruan shkurtimisht disa nga masat e sugjeruara për trajtimin e mangësive kritike

U fol më në detaje rreth indikatorëve si: të ardhurat, barazia, punësimi, mjedisi i punës dhe pritshmëritë nga puna.

## Agrobiznesi

Brenda sektorit të agrobiznesit, bimët mjekësore dhe aromatike (BMA) performojnë më mirë në treguesit e barazisë, por më dobët në të ardhurat dhe mjedisin e punës. Nënsektori i perimeve gjithashtu duket se performon relativisht mirë në treguesit e barazisë, por më dobët në perspektivat për të mësuar dhe për të përparuar në karrierë.

## Tabela 1. Gjetjet kyç të anketës, intervistave dhe fokus grupet me ndërmarrjet e sektorit të agrobiznesit

Të ardhurat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Si rezultat i pasigurisë nga ana e kërkesës, bizneset kërkojnë të ruajnë fleksibilitetin dhe të shmangin rrezikun në marrjen e vendimeve të punësimit, p.sh. së pari duke ofruar kontrata afatshkurtra (të rinovueshme 3- dhe 6-mujore). Kërkesa sezonale për punë përqendrohet pasigurinë e punës.</li> <li>Kur kushtet e tregut bëhen më të favorshme, bizneset raportojnë rritjen e pagave, duke treguar një lidhje pozitive mes produktivitetit dhe pjesës që zënë këto fitime (p.sh. në disa biznese mjekësore dhe barishtore).</li> <li>Megjithatë, vetëm pagat më të mira nuk kanë qenë të mjaftueshme për të zbutur nivelet e larta të qarkullimit dhe vendet e lira të paplotësuara – veçanërisht pasi pagat mbeten të ulëta në krahasim me opsionet jashtë vendit.</li> </ul>
Barazia	<ul style="list-style-type: none"> <li>Perceptimi i pabarazive në kapjen e vlerës, kjo sepse "gratë përbëjnë pjesën më të madhe të punëve, por marrin paga më të ulëta".</li> <li>Perceptimi i pabarazisë me bazë gjeografike: Disa pengesa kulturore për gratë në punë në zonën e veriut, por edhe atë të jugut të Shqipërisë</li> <li>Punëdhënësit injorojnë gjerësisht detyrimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara (të gjithë punëdhënësit publikë dhe privatë me 25 të punësuar duhet të punësojnë një person me aftësi të kufizuara)</li> </ul>
Punësueshmëria	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bujqësia që nuk shihet nga të rinjtë si një sektor i qenësishëm për të pasur një karrierë.</li> <li>Mekanizimi është i rëndësishëm si për BMA-të ashtu edhe për frutat dhe perimet. Kjo krijon mundësi për të fituar aftësi të reja, të cilat janë disi të transferueshme.</li> <li>Teknologjitë e reja dhe metodat e prodhimit janë gjithmonë në zhvillim, gjë që krijon një domosdoshmëri të fortë që shoqëritë tregtare të sigurojnë trajnim të vazhdueshëm, megjithëse kjo gjë nuk ndodh gjithmonë në praktikë.</li> <li>U zbuluan disa praktika të mira tek punëdhënësit, si për shembull, kur një nga pjesëtarët e stafit me përvojë trajnon një punonjës të ri.</li> </ul>
Mjedisi i punës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Puna në prodhimin bujqësor mund të jetë fizikisht e lodhshme dhe me orë të gjata</li> <li>Normat e qarkullimit mund të jenë shumë të larta. Një prodhues i fruta-perimeve tha se humbet 50% të fuqisë së punëtoare në bazë vjetore.</li> <li>Punonjësit në përgjithësi nuk përfshihen në vendimmarrje, dhe më së shumti konsultohen për vendimet që janë marrë tashmë. Por, disa biznese janë më proaktive, veçanërisht pasi kanë fituar standarde të caktuara si Global GAP/GRASP dhe Fair Wild pasi këto kërkojnë mbledhjen dhe përfaqësimin e shqetësimeve dhe ankesave të punonjësve.</li> </ul>
Pritshmëritë nga puna	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të rinjtë, bujqësia është shpesh "sektori i zgjidhjes së fundit"</li> <li>Nga të anketuarit që dëshironin të bënin karrierë në sektor, një numër kishte ambicien të "hapte një fermë të tyre". Megjithatë, të gjithë ishin të mendimit se kjo do të ishte shumë e vështirë për shkak të mungesës së mbështetjes.</li> <li>Sfida nuk qëndron tek kapacitetet, por më shumë tek stimujt. Thënë ndryshe, bizneset i shohin të rinjtë si të aftë, por jo gjithmonë të motivuar.</li> <li>U përmendën disa praktika novatore, të tilla si dhënia e çmimit "punonjësi i muajit" për të vlerësuar dhe shpërbluar punonjësit.</li> <li>Nënsektori të tjerë si fruta-perimet mund të jenë në thelb tërheqës për të rinjtë, si dhe kanë një lidhje mes nivelit të potencialit të mekanizimit/automatizimit dhe tërheqjes në rritje që të rinjtë kanë ndaj këtij sektori, veçanërisht nëse TIK mund të integrohet më mirë në "e-bujqësi".</li> </ul>

## Gjetjet e studimit për sektorin e agroturizmit

## Wisner: Shtetet e Bashkuara krenare të mbështesin bujqësinë e qëndrueshme në Shqipëri

"Shtetet e Bashkuara janë krenare të mbështesin nismat që nxisin bujqësinë e qëndrueshme në Shqipëri."

Kështu u shpreh i Ngarkuari me Punë i SHBA-së, në Tiranë David Wisner gjatë vizitës që zhvilloi me ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, në Bankën Shqiptare Gjenetike të Farave.

E krijuar me mbështetjen e USAID-it, kjo strukturë luan një rol kyç në ruajtjen e shumëllojshmërisë së të korrave në Shqipëri.

Wisner vlerësoi se, në një botë që përballlet me ndryshimet klimatike, kërkimi shkencor dhe



prodhimet e shëndetshme janë më të rëndësishme se kurrë për të garantuar sigurinë ushqimore. Banka Shqiptare Gjenetike

e Farave, është një qendër e rëndësishme ku ruhen mbi 5 000 aksesione të mbi 182 specieve bimore.

## Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, "Green Branding dhe Pozicionimi për Bizneset Shqiptare të Turizmit"

(Vijon nga fq 2)

mediae sociale nga individë të ndryshëm, influencues dhe madje edhe politikanë, duke tërhequr gjithnjë e më shumë vizitorë për të kaluar pushimet e tyre në këtë destinacion magjik. Gjithashtu e dashurur me natyrën shqiptare, në shumë raste, e rekomandoj Shqipërinë si një destinacion për miqtë e mi ndërkombëtarë. Reagimet e tyre kanë qenë gjithmonë pozitive, ku sigurisht në fjalë të parë kanë lavdëruar natyrën e mrekullueshme edhe mbresëlënëse të Shqipërisë.

Por sa më shumë rritet popullariteti i natyrës mahnitese të

Shqipërisë, aq më shumë lind natyrshëm pyetja lidhur me ofrimin e shërbimeve të bizneseve turistike. A janë bizneset e turizmit shqiptar, si restorantet, llojet edhe shërbimet për shpërndarjen e ushqimit, akomodimi privat, hotelitë, guidat turistike dhe aktivitete të tjera turistike të përgatitura dhe të pajisura mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e ndryshme të klientëve ndërkombëtarë?

Ndërsa bukuria natyrale e Shqipërisë pa dyshim kap vëmendjen e udhëtarëve nga e gjithë bota, është bërë e rëndësishme të vlerësohet nëse bizneset turistike shqiptare mund të përshatën dhe

të përmirësojnë shërbimet e tyre për të përmbushur kërkesat e klientëve ndërkombëtarë. Rritja e fluksit të turistëve kërkon njohuri të hollësishme të preferencave, jo vetëm për turistët vendas tashmë, por edhe për ata ndërkombëtarë, siç janë njohja e nuancave kulturore dhe pritshmëritë të tyre kur ata vizitojnë Shqipërinë. Përveç komenteve superlativë për bukuritë natyrore, në shumicën e rasteve, ajo çfarë kemi dëgjuar tjetër nga përvojat e vizitorëve ndërkombëtarë është gjithnjë e më shumë domosdoshmëria për të pasur shumë vëmendje ndaj cilësisë dhe konsistencës së shërbimit të ofruar.

# Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë - ShGShB aset në dobi të zhvillimit rural

Zef Gjeta boton librin "20 vjet Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë"

Zef Gjeta agronom, profesor i asociuar dhe doktor i shkencave bujqësore, publicist, autor tekstesh akademike, botues i disa librave, anëtar i Shoqatës së Gazetarëve të Bujqësisë, në një intervistë dhënë



për gazetën "Agrobiznesi", parashtron rëndësinë e medias jo vetëm në informimin e publikut por siç thotë: "Në ngritjen e zërit për problemet që shqetësojnë sektorin". Gjeta bën apel që Shoqata e Gazetarëve të Bujqësisë, "të kapë trendin e duhur" në përfaqësimin e sektorit dhe sfidat me të cilat ndeshet sektori rural sot.

## Intervista e plotë

Pyetje: Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë, organizoi pak kohë më parë një takim me anëtarësinë e saj, por edhe të futar të linjës. Cili ishte fokusi kryesor i këtij takimi? Ku u ndal më së shumti diskutimi i përfaqësuesve të gazetarisë së bujqësisë?

ZGj: Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë, tashmë ka mbushur 27 vite nga themelimi i saj dhe ka një gamë të gjerë të aktiviteteve që zhvillon në mënyrë periodike, ashtu edhe të aktiviteteve që zhvillohen në

mënyrë okasionale. Megjithatë nuk jemi të dhënë ndaj bujqësisë, kjo shoqatë ka anëtarë me aktivitet të gjerë dhe të gjithanshëm, organizohen aktivitete të larmishme dhe ShGShB është anëtare e Federatës Botërore të Gazetarëve të Bujqësisë: IFAJ – International Federation of Agriculture Journalists. Takimi i fundit ishte takim i rregullt (që mbahet rregullisht çdo vit) dhe ishte i lidhur me konkursin "Vasfi Samimi", një çmim që është stabilizuar në ShGShB dhe i jepet njërit prej anëtarëve, për artikullin më të mirë të botuar atë vit. Për këtë qëllim, ka një komision prej 3 anëtarësh, të cilët analizojnë dhe vlerësojnë artikullin më të mirë të botuar në vitin përkatës (këtë vit çmimi iu akordua Zef GJETES, me artikullin "Flora dhe fauna në Dukagjin").

Pyetje: Tashmë ky organizim i rëndësishëm në median shqiptare, dedikuar bujqësisë

sektorit më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit, që jep një kontribut me gati 20% të PBB dhe punëson rreth 40% të fuqisë punëtore është në jubileun e 20 të saj. Në këtë kuadër me iniciativën e prof. Zef Gjeta, ekspertit të njohur të bujqësisë që ka dhënë një kontribut të çmuar mjaft eficient në këtë fushë përmes njohurive akademike që zotëron në zbatimin e projekteve të ndryshme, që kanë kontribuar në ngritjen e ekonomive rurale në zona të ndryshme të vendit, është realizuar gjithashtu dhe një botim dedikuar SHGB në 20 vjetorin e ShGShB. A mund të na thoni çfarë prezanton ky botim? Cili është qëllimi i këtij botimi dhe cilat janë planet për të ardhmen në vijim të këtij botimi unik do të thojë?

ZGj: ShGShB gjatë gjithë viteve të aktivitetit të saj ka realizuar një sërë aktivitete, që nga takimi i ish Ministrave të bujqësisë, kontributi në organet e shtypit bujqësor e më gjerë, e deri tek takimet e kortezisë apo për relaks në bilanc të punëve të realizuara, në përvjetore të ndryshme, etj. E gjithë kjo punë është realuar me përkushtimin dhe kontributin e anëtarëve. Por, kjo punë e bërë, ashtu edhe këto gazetarë kishin nevojë që të ishin sa më të njohur dhe të vlerësuar. Për këtë arsye, menduam dhe realizuam një botim, ku përmbledhej një biografi e rrugës 20 vjeçare të përshkruar nga ShGShB, ashtu edhe një biografi të anëtarëve. Një pjesë

prej tyre (përfshi edhe dy drejtuesit e parë: Shefqet Meko dhe Fuat Memeli tashmë me banim në USA), të tjerë që janë ndarë nga kjo jetë, ashtu edhe gjithë ata anëtarë që jetojnë e vazhdojnë të kontribuojnë në këtë fushë të gazetarisë. Edhe ky botim është në fokusin e gazetarëve të bujqësisë të cilët janë mjaft punëtorë, por në të njëjtën kohë modestë.



Pyetje: Në kushtet e zhvillimeve aktuale sa po i përgjigjet gazetaria bujqësore nevojave dhe perspektivës të këtij sektori në vendin tonë? Në opinionin tuaj çfarë sygjerohet për të përmirësuar apo reflektuar me qëllim që gazetaria të kontribuojë me misionin e saj për informimin, ndërgjegjësimin e opinionit publik por jo vetëm.

ZGj: Vendi ynë është përfshirë në një valë të ndryshimeve të shpejta dhe të furishme, që

nuk lënë shumë kohë për të menduar, e që nuk të falen gabimet. E vërteta është që gazetaria bujqësore nuk e ka "kapur trenin e duhur", pasi organet e specializuara të shtypit bujqësor janë mbyllur (si pasojë e shkurtimit të fondeve publike për këtë gjë), ashtu edhe për shkak se nuk janë ndjekur sa dhe si duhet trendet. Në këto kushte të mungesës së shtypit të specializuar bujqësor-rural, duhet që të kishte një faqe të internetit, të dedikuar këtij aktiviteti. Ashtu edhe në mediat sociale duhet që të kishim llogarinë përkatëse, në mënyrë që të shërbenin si tribunë e shkëmbimit të mendimeve. Këtu nuk flitet vetëm për të gjetur një hapësirë të komunikimit të gazetarëve mes vetes, por më gjerë të komunikojë me ndjekësit, me specialistët e bujqësisë, me fermerët e deri edhe me konsumatorët urbanë, të cilët janë të interesuar si për origjinën e produkteve që konsumojnë, ashtu edhe fermerëve të shpërndarë në të katër anët e vendit.

Duhet thënë se në ditët tona, ka një problematikë të gazetarisë në lidhje me raportimet në fushën e bujqësisë dhe atë të zhvillimit rural: gazetarët kanë elementë që nuk i njohin sa dhe si duhet: duke filluar nga terminologjia (përdoren "pa doganë"/pa vend fjala prodhim "bio" apo "organik", nuk njohin sezonalitetin e prodhimit, nuk njohin specifikat e profesionit të blegtorit, të bariut apo atë të bujkut), e për pasojë

edhe raportimet apo emisionet e dedikuara dalin me mangësi.

Ka ardhur koha që kjo situatë të ndryshohet dhe faktori kryesor është në dorën e gazetarëve të bujqësisë, që fillimisht të sensibilizojnë për gjendjen, e gradualisht me punën dhe veprën e tyre, duke ndikuar edhe institucionet të ndryshojnë gjendjen. Kështu, është me rëndësi që vetë shoqata të ketë një faqe interneti të dedikuar, të jetë pjesë e rrjeteve sociale, të jetë më aktive me shkrime të problematikave shqetësuese, në ndihmë të fermerëve por edhe të politikëbërësve. Nga ana tjetër, duhet që të ketë një shkollë të nivelit master, ku gazetarë të përgjithshëm (por që merren me problematikë rurale), ku të specializohen për problematikën dhe konceptet bazë të zhvillimit rural. Apo mund të ndiqet rruga tjetër që shkruet të ndryshëm (që janë diplomuar në ndonjë fushë rurale, por që kanë pasion gazetarinë), të bëjnë një cikël master fokusuar në profesionin e gazetarisë. Një gjë e tillë do të plotësonte një hapësirë të zbrastë të krijuar në këto vite të tranzicionit.

Një hap tjetër pozitiv, do të ishte një ftesë për anëtarësim në ShGShB të të rinjve gazetarë nga fusha të ndryshme, të cilët janë të interesuar që të fokusohen në fushën e zhvillimit rural. Kjo gjë do të ndihmonte që shoqata të bëhet më e fortë, më e larmishme dhe në të njëjtën kohë, krijon mundësinë që të lindin iniciativa të reja. Në përgjithësi, vendi ka nevojë që të rritet më tej kontributi dhe profesionalizimi i gazetarisë në fushën e zhvillimit rural, në kushtet kur vendi ynë po hedh hapa të sigurtë drejt integritimit në bashkësinë europiane.

Të rinjtë gjithnjë e më shumë po i drejtohen arsimit profesional, si rruga më e sigurtë drejt punësimit.

Agjencia Telegrafike Shqiptare ishte këtë javë në Fier, ku vëzhgoi nga afër procesin mësimor në shkollën profesionale "Rakip Kryeziu", ku Bujqësia, Blegtoia, Infermieri dhe "Teknologjia e Informacionit" janë degët të cilat kanë interes gjithnjë e më të lartë nga të rinjtë e zonës dhe jo vetëm, pasi shkolla disponon një konvikt me kushte moderne. Ndërkohë, risi për shkollën është dhe mundësia që nxënësit të zgjedhin degën e agroturizmit në vitin e tretë.

"Në këtë vit mësimor, në krahasim me vitin mësimor 2022-2023, trendi i nxënësve ka ardhur duke u rritur. Shkolla jonë është në një projekt të përbashkët mes qeverisë italiane dhe asaj shqiptare, që synon ta kthejë shkollën në një qendër multifunksionale dhe në një qendër ekselence në fushën e zhvillimit të biznesit bujqësor dhe në trajnimin e fuqisë punëtore në sektorin e Bujqësisë, jo vetëm për qarkun e Fierit, por për të gjithë Shqipërinë", tha për ATSH, drejtori i Shkollës Profesionale "Rakip Kryeziu",

## Në shkollën profesionale "Rakip Kryeziu" në Fier, të rinjtë orientohen në zanatet e biznesit bujqësor e blegtoral

Alket Merdanaj.

Sipas tij, në këtë shkollë është ndërmarrë një investim i përbashkët mes qeverisë italiane dhe asaj shqiptare. "Është investuar në godinën kryesore dhe në godinën e konviktit, që i është nënshkruar rikonstruksionit total. Shumë shpejt do të nisi edhe ndërtimi i bazës prodhuese, me të gjitha standardet më të mira, për të ofruar rritjen profesionale të nxënësve, por edhe për të pasur përfitime ekonomike dytësore për shkollën. Gjithashtu do të investohet edhe në një serrë 4000 metër katrorë të standardeve të më larta teknologjike, që do të shërbejë jo vetëm për praktikën profesionale, por ku shkolla do përpiqet të vjelë të ardhura dytësore përmes aktivitetit të vet bujqësor", tha Merdanaj më tej.

Ilva Kalemi, nxënëse e vitit të parë për shërbime sociale dhe infermieri, tha se ka zgjedhur këtë degë, pasi tregu i punës ofron mundësi konkrete punësimi. "Jam në vitin e

parë. Sapo përfundam orën e italishtes. Më pëlqen kjo degë pasi më jep mundësi t'iu vijë në ndihmë njerëzve dhe po



ashtu është një profesion, që ka kërkesa në tregun e punës", tha ajo.

Klajdi Veizi, nxënësi i vitit të parë për infermieri tha se i pëlqen të jetë pranë njerëzve që kanë probleme shëndetësore, teksa shtoi se "Shqipëria ka shumë nevojë për infermierë".

Ermal Yzeiri, drejtues i

Njësisë së Zhvillimit, u shpreh për ATSH se, "Shërbimet Sociale Shëndetësore ose infermieri i realizojnë praktikën

tregu i punës dhe familja. "Më së shumti janë të interesuar për mbarëvajtjen e kafshëve bujqësore, pasi edhe zhvillimi që ka marrë sot fjerma blegtorale e kërkon një gjë të tillë, me qëllim rritjen e rendimentit në prodhimin të qumështit, mishit...etj. Është një degë e zgjedhur ndoshta dhe nga familjarët e tyre, por edhe e diktuar nga tregu i punës", tha Baboçi.

Eduard Ishilaj, nxënësi i vitit të tretë për veterinarinë nëvizoi se qëllimi i tij është të hapë vetë një klinikë për të kryer ndërhyrjet kirurgjike të kafshët. "Kam ndjekur degën e veterinarisë pasi ma ka transferuar këtë pasion babai im, që është veteriner i zonës së Llakatundit. Pas mbarimit të shkollës profesionale, dua të vazhdojë shkollën e lartë për veterinarinë në Universitetin Bujqësor në Tiranë. Kemi bërë praktikë në zona të ndryshme dhe tek baza e shkollës. Në përfundim të universitetit, do zgjedh të specializohem për kirurgji dhe pse jo të kem

dhe klinikën time", tha ai.

Gert Xhafaj, nxënësi i vitit të parë për veterinarinë, rrëfeu se shkollën në fjalë e ka zgjedhur për shkak të këshillës që ka marrë nga një veteriner mikeshë e tij, që ka përfunduar shkollën pikërisht tek "Rakip Kryeziu".

"Ndjek veterinarinë. Këtë shkollë ma rekomandoi një mikja ime që ka përfunduar këtu për veterinarinë. Më pëlqen mësuesit dhe shkolla. Për këtë profesion ka kërkesë jo vetëm në Shqipëri, por dhe jashtë saj. Nëse arrij, pse jo të kem dhe një biznes timin në fushën e veterinarisë", tha ai.

ATSH vrojtoi nga afër dhe bazën prodhuese të shkollës profesionale "Rakip Kryeziu".

"Në ambientet e bazës prodhuese, kemi 11 krerë lopë të racave të ndryshme, 20 krerë dele. Këtu bëhen praktikat profesionale, 70% e realizojmë në shkollë, ndërsa pjesa tjetër kemi kontrata bashkëpunimi me biznese të ndryshme. Kemi kryerjen e injeksioneve në kafshë, metodat e fiksimit, kontrollit, monitorimit shëndetësor, mirëmbajtjes, ushqimit...etj", theksoi Ermal Yzeiri, drejtues

## NJERËZIT E PUNËS

## Model agroturizmi, “Mrizi i Zanave” bashkëpunim me 400 fermerë të zonës

Altin Prenga është një prej atyre që finalizoi idenë e tij gjennale për një restorant mes natyrës, ku çdo gjë prodhohet në fshat, në Fishtë të Lezhës.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj

“Përkushtimi i tij ndaj zhvillimit dhe bashkëpunimit me 400 fermerë të zonës, i ka ndihmuar ata në përmirësimin e teknikave bujqësore, menaxhimin e prodhimit dhe rritjen e produktivitetit në këtë sektor”,

misë familjare dhe lokale.

“Ne do të vazhdojmë të mbështesim çdo iniciativë në fushën e agroturizmit. Shqipëria ka një natyrë të mrekullueshme dhe prodhime fantastike në çdo anë të saj. Na duhen shumë “Mrize” të tjera”, u shpreh Denaj.

“Mrizi i Zanave” në fshatin Fishtë të Lezhës, prej kohësh tashmë është kthyer në një nga bujtinat më të zëshme në vend, që mirëpret turistë nga vendi dhe të huaj, duke përfaqësuar një shembull të vërtetë suksesi në agroturizëm.

Sipërmarrësi Altin Prenga ishte ndër të parët që mori certifikatën e agroturizmit.

Vit pas viti, ai ka realizuar investime duke shtuar dhe pasuruar jo vetëm menunë e restorantit, por edhe ngritjen e dhomave për akomodimin e turistëve.

Ky sezon turistik ka pritshmëri të jetë tejet i mbarë, pasi shifrat e vizitorëve që në muajt e parë të vitit flasin për rritje të fluksit.



gjatë bashkëpunimit me Altin e cilësoi “Mrizin e Zanave” një model biznesi të agroturizmit që frymëzon për produktet, gatimet e mrekullueshme dhe me një kulturë shërbimi jashtëzakonisht cilësore.

u shpreh Denaj.

Ministrja tha se, sot mesatarisht një agroturizëm është i lidhur me 20 familje në zonë për produkte dhe 10 hektarë tokë, çka do të thotë angazhim, punësim dhe rritje të ekono-

### FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE

## “Nga artet dhe zanatet në produkte dizajni”, panairi kushtuar fuqizimit ekonomik të grave

Në qendrën Destil u zhvillua një panair i fokusuar tek aftësitë krijuese dhe tregtare të grave. Ky panair ishte finalizimi i trajnimeve të ndryshme pjesë e projektit “Fuqizimi Ekonomik i Grave dhe perspektiva gjinore në zinxhirin e vlerave të biznesit”.

Projekti trajton çështje të barazisë gjinore dhe fuqizimit ekonomik të grave në mes të pasojave dhe sfidave të pandemisë COVID-19 dhe ndryshimeve klimatike. Ky projekt mbështetet nga Gender Equity and Equality Action (GEEA) i Departamentit të Shtetit. Projekti është implementuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, në territorin e Bashkisë Tiranë dhe me qëllim fuqizimin e grave sipërmarrëse.

Projekti është përqëndruar në disa sektorë të veçantë si artizanati, agroturizmi, tekstilet

dhe prodhimi i vajit të ullirit, duke reduktuar pasiguritë me

për fuqizimin ekonomik, buxhetin, bankat e sigurimet; 1 tra-



të cilat gratë përballeshin përmes një analize gjinore të zinxhirit të vlerave të biznesit.

Për të arritur në këtë stad, u deshën 27 trajnime, ndër të cilat: 4 për marketingun; 21

njim për tregtinë elektronike; 1 trajnim për rritjen personale të grave sipërmarrëse.

Gjithësej u trajnuan 453 gra sipërmarrëse nga 24 ekspertë të sektorëve të ndryshëm.

## Në shkollën profesionale “Rakip Kryeziu” në Fier, të rinjtë orientohen në zanatet e biznesit bujqësor e blegtoral

(Vijon nga faqja 4)

i Njësisë së Zhvillimit.

Anila Gero, mësuese e Departamentit të Bujqësisë u bëri apel të gjithë atyre që kanë në pronësi tokë apo ferma blegtorale të shkollojnë fëmijët e tyre në arsimin profesional.

“Është shumë e rëndësishme që nxënësit apo fëmijët e fermerëve të ndjekin drejtimin mësimor bujqësi, pasi secili nga këta fermerë kanë në pronësi të tyre tokë, që duhet të mbillet dhe duhet

menaxhuar që prodhimet të tregtohen brenda dhe jashtë Shqipërisë. Vetëm këtë vit kemi pasur goxha regjistrime në krahasim me vitin e shkuar në bujqësi dhe veterinarin”, tha ajo.

Blerina Ahmeti, nëndrejtoresha e konviktit, tha se “menca ofron ushqim tre herë në ditë me një dietë sipas një vendimmarrjeje të këshillit drejtues të konviktit. Kemi 22 dhoma, banojnë 4 nxënës në dhomë. Secila ka tualetin më vete. Kanë orarin e studimit

tek biblioteka ku çdo pasdite vijjnë nxënësit. Ka kompjuterë, materiale ndihmëse dhe është realizuar në bashkëpunim mes qeverisë shqiptare dhe Italisë”, tha ajo.

Shkollat profesionale në vendin tonë tashmë kanë në pjesë të tyre dhe njësinë e zhvillimit, e cila synon lidhjen e nxënësit me tregun e punës, praktikat mësimore, binjakëzimet apo dhe universitetin, për ata që duan të thellojnë njohuritë e tyre tek fusha e përzgjedhur.

## Dikur emigrantë sot eksportues, historia e vëllezërve Aleksandër e Tomorr Dulaj nga Portëza e Fierit

Aleksandër dhe Tomorr Dulaj ne Portezë të Fierit, pas shumë vitesh emigrim, në vitin 2013-të u rikthyen në vendlindje dhe vendosën që kursimet t’i investonin për ndërtimin e serave.

Të angazhuar familjarisht në këtë biznes familjar ata arritën brenda një kohe të shkurtër të shtojnë sipërfaqet e kultivuara kryesisht me domate.

I gjithë prodhimi cilësor tashmë ka siguruar tregun në vendet e Bashkimit Europian duke i dhënë më shumë identitet prodhimeve shqiptare.

Problem për bujqit ngelet dhe lista e pesticideve që janë



te ndaluara në vendet e BE.

Vëllezërit Dulaj thonë se duan ta shtojnë sipërfaqen e

serave, e përveç anëtarëve të familjes të punësojnë edhe të tjerë nga fshati e zona.

## Mbështetje nga Skema Kombëtare, vëllezërit Tatani në Kavajë ndërtuan stallën me 250 gjedhë

Vëllezërit Tatani në fshatin Rrakull, Kavajë, janë një shembull sesi nga iniciativa të vogla familjare mund të arrihen rezultate fitimprurëse.

Të palodhur në punën e tyre të përditshme si blegtorë, kanë ndërtuar një stallë me një numër prej 250 krerësh gjedhë dhe prodhojnë një sasi prej 20 kv qumësht në ditë, me të cilin furnizojnë fabrikat e përpunimit të qumështit në zonë.

Ata janë mbështetur nga Skema Kombëtare 2023 për masën e tufës bazë të matrikulluar, duke

i ndihmuar në lehtësimin e kostove dhe në të ardhmen para-

shikojnë zgjerimin e mëtejshëm të kapaciteteve të kësaj stalle.



## Ismet Gega, fermieri që punon mbi 150 hektarë tokë të mbjella me grurë e misër

Qeveria po vijon me politika mbështetëse për fermerët, në mënyrë që prodhimet bujqësore shqiptare të konkurrojnë ato të rajonit në cilësi dhe çmim.

Një ndër to është dhe ajo për mbështetjen financiare direkte për prodhimin e grurit në vend.

Ministri i Brendshëm Taulant Balla solli në vëmend-

je historinë e një prej fermerëve nga Levani i Fierit, i cili shfrytëzon dhe punon mbi 150 hektarë tokë me të mbjella bujqësore, si grurë, misër dhe foragjere.

Balla e konsideroi një histori suksesi fermerin Ismet Gega.

Masa e mbështetjes së grurit përmes skemës kombëtare

“Mbështesim prodhimin e grurit në vend”, për të përfituar shumë prej 30 mijë lekë/hektar ishte një risi në Skemën Kombëtare, e cila dha ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e sipërfaqeve të mbjella, me qëllim plotësimin e nevojave vendase dhe shmangien e importit.

## Laguna e Nartës, oaz i shpendëve migratorë

Turizmi i vëzhgimit të shpendëve uJORË po tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë në zonat e mbrojtura në Shqipëri.

Ky lloj turizmi është një mundësi e mirë për të afruar njerëzit me shpendët dhe për t’u treguar atyre se çfarë t’paresh dhe vlerash ka secili shpend.

Administrata e Zonave të Mbrojtura Vlorë ka zhvilluar një vëzhgim të shpendëve në lagunën e Nartës për të njohur më nga afër situatën aktuale.

“Laguna e Nartës është një oaz i shpendëve të ujit, e cila krijon habitate mjaft të

përshtatshme për periudhën dimërore, ku një numër i madh i shpendëve migratorë kanë filluar të popullojnë lagunën”, theksoi Agjencia kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Turizmi i vëzhgimit të shpendëve apo kafshëve të egra, tashmë po kthehet në një lëvizje të vërtetë turistike edhe për vendin tonë.

Kjo lagunë përfaqëson një territor me një shumëllojshmëri shpendësh, të cilët gjejnë aty një habitat të përkryer për të folezuar apo dimëruar. Një shfaqje biodiversiteti, që mes të tjerash përbën edhe një hallkë

të rëndësishme të zinxhirit të mbijetesës së shpendëve, në sezonet e shtegtimt. Kjo lagunë, pjesë kyç e korridorit të shtegtimt të Adriatikut lindor, përbën një nga ekosistemet ligatinore më të rëndësishme të Shqipërisë.

Ky territor mbart një numër të konsiderueshëm shpendësh, shumë prej të cilëve gjenden të listuar në direktivën evropiane të shpendëve, si dallëndyshja e detit (Glareola pratincola), sqepbiza (Recurvirostra avosetta) apo dallëndyshja e detit ballëbardhë (sternula Albifrons).

## MOZAIK NGA BUJQËSIA

## Denaj: Bashkëpunim me PNUD për avancimin e sektorit bujqësor

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj

zhvillimin e zinxhirëve të vlerës në sektorin bujqësor të

ndihmuar fermerët shqiptarë në arritjen e standardeve të kërkuara për të konkurruar në tregjet elitare.

“Kjo përfshiu diskutime mbi trajnimet, teknologjinë, dhe mbështetjen financiare si mjete kyçe për përmirësimin e cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe rritjen e konkurrueshmërisë në nivel ndërkombëtar”, u shpreh Denaj.

“Takimi shënoi një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimit të thelluar mes qeverisë shqiptare dhe PNUD-it, për avancimin e sektorit bujqësor dhe zhvillimin rural, si dhe vijimin e punës për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”, theksoi ministria Denaj në një postim në rrjetet sociale.



priti në një takim përfaqësues- en e PNUD, Monica Merino.

Në takim u diskutua rreth projekteve të mundshme për

Shqipërisë.

Denaj bëri të ditur se, biseda u përqendrua në strategjitë dhe ndërhyrjet e nevojshme për të

## 40 ferma shqiptare të ngarkuara në sistemin RICA1 të BE-së

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) është duke mbështetur specialistët e ekspertëve të bujqësisë me trajnime në mbledhjen e të dhënave për Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë (FADN).

Trajnimet e vazhdueshme me stafin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural synojnë të rrisin kapacitetet e mbledhjes së të dhënave për plotësimin dhe analizimin e të dhënave financiare dhe ekonomike në nivel ferme, duke kontribuar përfundimisht në formulimin e politikave dhe praktikave të qëndrueshme bujqësore.

Në Shqipëri është vendosur një bazë e zhvillimit të FADN, ku janë mbledhur të dhënat nga 40 ferma dhe

ngarkuar në sistemin RICA1 të BE-së.

MBZHR së bashku me

hjen e të dhënave të FADN në 21 ferma shtesë ku FAO ofron trajnime në vendin e pu-



ekipin e projektit FAO kanë vendosur të zgjerojnë mbled-

nës për shërbimin e zgjerimit të sektorit.

## Skema Kombëtare e Mbështetjes, Denaj: 100% financim blegtorëve për tufat bazë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj shprehu mbështetjen maksimale të qeverisë për sektorin e blegtorisë.

Denaj tha se, krahas mbështetjes për matrikullimin e blegtorisë, qeveria përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi, subvencionon të gjithë blegtorët për mbarësitimin e gjedhit dhe të imtave.

“Adresojmë 100% mbështetje për blegtorët për masën e mbështetjes së tufës bazë të matrikulluar me lopë dhe për masën e mbështetjes së tufës bazë të matrikulluar me dele/dhi”, tha Denaj.

Sipas saj, këtë vit, me shtesën në buxhet për Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi, kanë marrë 100% të

financimit 2,950 blegtorë për 60,661 krerë lopë dhe 4,678 blegtorë për 909,322 krerë dele/dhi.



## “Dëftesat tregtare”, garancia e fermerëve për kreditim - Skema se si do funksionojë. “Shteti të marrë përsipër kostot nëse produkti dëmtohet”

“Shteti duhet të dalë garant dhe të marrë përsipër kostot nëse produkti bujqësor i fermerëve dëmtohet”. Është ky një prej rekomandimeve të bëra nga Rrjeti Shqiptar i Zhvillimit Rural për nismën e Qeverisë e cila ka të bëjë me dëftesat tregtare. Por çfarë parashikohet në këtë draft? Konkretisht, Ministria e Bujqësisë ju krijon mundësinë fermerëve që të marrin kredi duke lënë kolateralin prodhimin.

Në momentin e dorëzimit të produktit ata do të pajisen me dëftesë tregtare, një dokument ky që do të dorëzohet në bankë dhe përmes të cilit do të bëhet e mundur marrja e kredisë.

Por Alba Tema, përfaqësuese e Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural thotë se qytetarët por edhe bankat nuk kanë sigurinë që produkti nuk do të dëmtohet prej fatkeqësive natyrore, të cilat janë

të paparashikueshme. Në këto kushte, shton ajo duhet që shteti

itetin e tyre. Dëftesa tregtare do të shërbejë si kolateral për t'u



“DËFTESAT TREGTARE”, GARANCIA E FERMERËVE PËR KREDITIM  
SKEMA SE SI DO FUNKSIONOJË. “SHTETI TË MARRË PËRSIPËR KOSTOT NËSE PRODUKTI DËMTOHET”

të dal garant në bankë, duke marrë përsipër shlyerjen apo likuidimin e kredisë.

Përmes kësaj nisme ligjore të prezantuar në fillim të muajit nëntor synohet rritja e financimeve në bujqësi dhe nxitja e fermerëve për të zgjeruar aktiv-

financuar nga sistemi bankar. Të dhënat ndër vite tregojnë që aksesin në programet e kreditimit është i ulët për shkak të pamundësisë që në jo pak raste kanë fermerët për të përmblusur apo plotësuar kushtet e bankës.

## BERZH mbështet projektin për klimën dhe zhvillimin e bujqësisë


Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, miratoi në mbledhjen e së martës, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë”.

Marrëveshja e huasë me BERZH, në vlerën 64.6 milionë euro ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë; promovimin e bujqësisë inteligjente klimatike dhe rritja e përputhshmërisë me standardet e sigurisë e të cilësisë së ushqimit dhe forcimin e kapaciteteve të analizave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Albert Mësonjësi, tha se, “projekti është në koherencë me vizionin e Strat-

egjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030 dhe në përputhje me Strategjinë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027, në përmbushje të 3 objektivave: Promovimi i prodhimit dhe cilësisë së qëndrueshme të ushqimit; Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe veprimet klimatike për të zbutur ndikimin negativ, si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe Forcimi i strukturës socioekonomike të zonave rurale, përmes promovimit lokal, përmirësimit të punësimit dhe biznesit në fermë.

Konkretisht, shpjegoi Mësonjësi, projekti do të mbështesë katër shtylla kryesore:



1. Promovimin e bujqësisë inteligjente klimatike dhe aksesin në tregje nëpërmjet investimeve për zhvillimin e zinxhirëve të shkurtër të

vlerës; zhvillimin e grupeve tipike të produkteve ushqimore apo zinxhirëve të vlerës në zona të caktuara; zhvillimin e një platforme informative

për bujqësinë inovative klimatike për të mbledhur të gjithë informacionin përkatës.

2. Fuqizimin e skemave të ujitjes dhe të kullimit në

zonat me bujqësi intensive dhe kultivim të kultivarëve me vlerë të lartë, konkretisht: Investimi në skemën ujëtëse të Mursisë dhe Divjakës; Skemat alternative për ujitjen në bashkinë Lushnjë; Modernizimi i sistemeve të kullimit.

3. Rritja e përputhshmërisë me standardet e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit. Mbështetje për laboratorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe pikave të inspektimit kufitar; Përmirësimi i kapaciteteve inspektuese dhe mbështetjes diagnostike në fushën e sigurisë ushqimore; Zhvillimi i kapacitetit të ruajtjes përmes ndërtimit të objekteve të magazinimit dhe blerjen e pajisjeve.

4. Forcimi i kapaciteteve të analizave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet rritjes së një sistemi inteligjence biznesi.





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**

## BUJQËSIA NË BOTË

## Partnerët natyrorë, Bashkëpunimi bujqësor është një shtytës i fuqishëm i sinergjisë në rritje të Afrikës dhe Kinës

Bujqësia përfaqëson një pjesë të rëndësishme të miqësisë dhe bashkëpunimit Afrikë-Kinë dhe ka një rëndësi thelbësore për të dyja. Përfshirja kineze në bujqësinë afrikane ka një histori të gjatë që daton nga fundi i viteve 1950, kur Kina filloi të ofrojë mbështetje bujqësore për kontinentin. Modeli i bashkëpunimit bujqësor i Kinës në Afrikë është formuar përmes aplikimit të përvojave nga zhvillimi bujqësor i Kinës në kontinentin afrikan. Afrika është plotësisht e vetëdijshme se Kina ka arritur të prodhojë një të katërtën e drithit në botë dhe të ushqejë një të pestën e popullsisë së botës me më pak se 10 për qind të tokës së punueshme në botë, e cila është një arritje jetike në ndjekjen e sigurisë ushqimore dhe të ushqyerit. jo vetëm për Kinën por për botën.

një shtytës të rëndësishëm të rritjes, zhvillimit dhe vendeve të punës në kontinent. Bashkimi Afrikan miratoi Programin e tij Gjithëpërfshirës të Zhvillimit të Bujqësisë në Afrikë në 2003, një kuadër i cili synon të përshpejtojë transformimin e koordinuar ekonomik dhe strukturor duke përmirësuar produktivitetin bujqësor, duke arritur sigurinë ushqimore, duke rritur investimet dhe duke ndarë njohuritë.

Gjatë dekadës së fundit, bashkëpunimi bujqësor Afrikë-Kinë në rritje të shpejtë është përqendruar gjithnjë e më shumë në bashkëpunimin e zgjeruar midis Programit



vende dhe më shumë se 30 organizata ndërkombëtare në kuadrin e BRI. Afrika përballet me një deficit të madh të financimit të infrastrukturës dhe 52 vende dhe Komisioni i Bashkimit Afrikan janë angazhuar për iniciativën si nënshkruese. I mbështetur nga qëllimet e koordinimit të politikave, lidhjes, tregtisë së papenguar, integritimit financiar dhe marrëdhënieve mes njerëzve, BRI ka shënuar mbi 3000 projekte zhvillimi duke përfshirë portet, autostradat, hekurudhat, termocentralet, rrjetet pa tela 4G dhe 5G, urat, dhe aeroportet, të cilat të gjitha kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në promovimin dhe modernizimin e sektorëve industrialë dhe bujqësorë në Afrikë dhe në disa vende në zhvillim.

Nënshkrimi i Planit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës dhe Bashkimit Afrikan për Promovimin e Përbashkët të Ndërtimit të Brezit dhe Rrugës në dhjetor 2020 siguroi vull për bashkëpunimin e ardhshëm të zgjeruar Një brez, një rrugë. Kjo marrëveshje konstruktive, ndër të tjera, përcakton qëllimin dhe përmbajtjen e projekteve kyçe të bashkëpunimit të BRI-së në fusha të tilla si infrastruktura, lidhja, komunikimi, lehtësimi i tregtisë së papenguar, rritja e shkëmbimeve mes njerëzve, aksesit në financim dhe hartimi i orareve të ardhshme.

Për sa i përket të ardhmes

së bashkëpunimit të zgjeruar bujqësor Afrikë-Kinë, udhëheqësit afrikanë u inkurajuan më së shumti për një sërë ngjarjesh shumë konstruktive, të lidhura me bashkëpunimin bujqësor në rritje dhe përfitim të ndërsjellë, bazuar ndër të tjera në zgjerimin e bashkëpunimit Afrikë-Kinë në kontekstin e FOCAC dhe BRI.

Ngjarja e parë e shënuar që padyshim injektoi një vull të rëndësishëm në miqësinë e Afrikës dhe Kinës ishte Dialogu i Liderëve Kinë-Afrikë në Johannesburg më 24 gusht, gjatë të cilit u njoftua se Kina do të nisë një plan që do të mbështeste modernizimin bujqësor të Afrikës. Ky plan do të synojë gjerësisht në mbështetjen e Afrikës për të zgjeruar plantacionet e grurit

brez, një rrugë për Bashkëpunim Ndërkombëtar më 18 tetor në Pekin, tetë hapa të mëdhenj u njoftuan nga Kina në mbështetje të ndjekjes së përbashkët të bashkëpunimit me cilësi të lartë. Një brez, një rrugë.

Këto masa të rëndësishme ndër të tjera përqendrohen në promovimin e bashkëpunimit të bazuar në integritet, një rrjet shumëdimensional i nismës Një brez, një rrugë, promovimin e zhvillimit të gjelbër, avancimin e inovacionit shkencor dhe teknologjik, vazhdimin e bashkëpunimit praktik të gjithanshëm dhe mbështetjen e shkëmbimeve mes njerëzve. Të gjithë këta janë hapa që do të kenë një ndikim të gjerë dhe do të japin rezultate të prekshme për bashkëpunimin bujqësor midis Afrikës dhe Kinës.

Që nga fillimi i BRI-së, janë nënshkruar gjithsej 34 dokumente të bashkëpunimit bujqësor me 19 vende afrikane, AU dhe Aleancën për një Revolucion të Gjelbër në Afrikë. Kina ka ndërtuar 24 qendra demonstrimi të teknologjisë bujqësore në Afrikë, duke përfutur më shumë se 1 milion fermerë të vegjël në kontinent. Për sa i përket shkëmbimeve të personelit, Kina kohët e fundit ka dërguar gjithashtu më shumë se 400 ekspertë bujqësor në Af-



Bujqësia është një burim kryesor i të ardhurave për shumicën e vendeve në Afrikë dhe veçanërisht për popullsinë rurale të pjesëve të gjera të saj. Ajo përbën mbi gjysmën e punësimit total të kontinentit dhe më shumë se 32 për qind të prodhimit të brendshëm bruto të Afrikës. Edhe pse Afrika zotëron 60 për qind të tokës së papunuar dhe të punueshme në botë, ajo ka mbetur një importues neto i ushqimit. Duke marrë parasysh rëndësinë e sektorit të bujqësisë për shumicën e vendeve afrikane, Afrika në përgjithësi ka nevojë për bashkëpunim dhe mbështetje teknike, edhe pse ajo vazhdon të përparojë.

Është në këtë kontekst që qeveritë afrikane e kanë parë vazhdimisht bujqësinë si

Gjithëpërfshirës të Zhvillimit të Bujqësisë Afrikane të Afrikës (CAADP) dhe qëllimeve të tij, dhe Forumit për Bashkëpunimin e Kinës dhe Afrikës dhe Iniciativës Një brez, një rrugë, e cila të përvijojë gjithnjë e më shumë masa konkrete që synojnë zbatimin e vazhdueshëm të KVZHP. Megjithatë, ka ende hapësirë për bashkëpunimin bujqësor për të përmirësuar dhe për të mundësuar që bujqësia afrikane të kontribuojë konkretisht në arritjen e qëllimeve kombëtare dhe kontinentale, ndër të tjera, Axhendën e Bashkimit Afrikan 2063 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Gjatë 10 viteve të fundit, Kina ka lidhur 200 marrëveshje bashkëpunimi me 152



dhe për të inkurajuar kompanitë kineze për të rritur investimet bujqësore në Afrikë.

Gjatë Forumit të tretë Një

rikë dhe ka trajnuar më shumë se 10,000 personel menaxherial dhe teknik për vendet afrikane. Bashkëpunimi në bujqësi

është i dobishëm si për Afrikën ashtu edhe për Kinën. Me Kinën duke udhëhequr rrugën në modernizimin e bujqësisë përmes investimeve të rëndësishme në kërkimin shkencor dhe teknologjinë, ajo paraqet një mundësi të madhe për Bashkimin Afrikan për të shfrytëzuar dhe nxitur transformimin e zinxhirit të vlerës së prodhimit bujqësor, agro-industrisë dhe agro-ushqimore të Afrikës.

Ajo që ka gjithashtu një rëndësi në rritje është se Afrika po i jep gjithnjë e më shumë përparësi nevojës për të nisur një tregti më të ndërlidhur bujqësore në vazhden e krijimit të Zonës Afrikane Kontinentale të Tregtisë së Lirë. Një nga qëllimet kryesore të kësaj nisme është ndërlidhja, e cila gjithnjë e më shumë rezonon me BRI. Si i tillë, ndërtimi i hekurudhave nën kuadrin e BRI-së ka rritur marrëdhëniet tregtare midis vendeve afrikane.

Hekurudha Mombasa-Nairobi e financuar nga Kina në Kenia raportohet të ketë rritur numrin e pasagjerëve me mbi 150 për qind dhe kapacitetin vjetor të ngarkesave me mbi 104 për qind. Lidhja e Zonës Afrikane Kontinentale të Tregtisë së Lirë dhe BRI ka një potencial të madh për vendet afrikane për të përmirësuar tregtinë ndër-afrikane dhe për të nxitur zinxhirët e furnizimit të importit dhe eksportit global.

Afrika i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit të saj të dobishëm bujqësor me Kinën, i cili është rritur me shpejtësi, duke krijuar një bazë solide për bashkëpunimin praktik në të ardhmen. Ky bashkëpunim dëshmon edhe një herë se Kina ka ndjekur drejtimin e duhur në avancimin e bashkëpunimit të BRI-së me kontinentin dhe se partnerët e BRI-së në Afrikë vazhdojnë të tregojnë përkushtim të vendosur për të marrë pjesë dhe për të nisur projektet me cilësi të lartë Një brez, një rrugë për përfitime reciproke.

Autori Gert Gobler është studiues në Institutin e Studimeve Afrikane në Universitetin Normal të Zhejiang dhe një ish-diplomat në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimit të Afrikës së Jugut.

### KËNDI I MBROJTJES INTELEKJENTE TË BIMËVE

## Praktikat agronomike, si masa parandaluese të dëmtimeve të bimëve nga insektet, sëmundjet dhe barërat e egra

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike



të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) (Shih grafikun me poshte)

Bujqësia e qëndrueshme, (piramida djathtas) quhet e tillë, sepse baza e piramidës është më e gjerë. Në bazën e saj të gjerë, janë pikërisht tërësia e praktikave, masave agronomike parandaluese. Në bujqësinë konvencionale, (piramida majtas), fillohet direkt me masat kimike. Kjo piramidë ka bazë të ngushtë, sepse ato vrasin direkt parazitin dhe

nuk ndikojnë në kushtet komplekse tokësore dhe agronomike, të cilat pengojnë shtimin e popullatës së këtij paraziti. P.sh., nëse shmangim qarkullimin bujqësor, do të na duhet shumë më tepër kimizim për të mbajtur nën kufirin e dëmit ekonomik numrin e insekteve, sëmundjeve ose barërat e egra në parcela.

Edhe në mbrojtjen e bimëve praktikohen shumë masa parandaluese, masa të cilat përsosen

gjithmonë. Cilat janë disa nga këto praktika agronomike.

#### • Përzgjedhja e vendit, si zonë ekologjike dhe mikrozonë

Çdo bimë bujqësore ka preferencat e veta për vendin ku mbillet. Me vendin kemi parasysh si llojin e tokës që ajo parapëlqen, ashtu edhe pozicionin ndaj ujërave, maleve, kushteve të klimës, qarkullimeve ajrore, përkundrimi ndaj

diellit, anës veriore ose jugore të horizontit.

Bimët të cilat nuk parapëlqejnë praninë e lagështirës ajrore dhe tokësore, janë të prirura të preken nga sëmundjet dhe dëmtuesit. P.sh., vreshtat e ngritura në lugina, pranë përrenjve dhe lumenjve duan më shumë kujdes për mbrojtjen nga sëmundjet.

Ullishtet nuk kanë kushte të sigurta klimaterike kur ato janë mbjellë shumë në veri të

vendit, p.sh. në Malësinë e Madhe. Ka vite kur në këto zona temperaturat bien minus 5-7 °C, kushte kur ullishtet dëmtohen fizikisht. E kundërta ndodh me bimën e arrës, e cila parapëlqen buzët e përrenjve dhe lumenjve, luginat.

#### • Përzgjedhja e tokës

Pemët frutore bërthamore si pjeshka, kajsia, kumbulla, të mbjella në kodra të thata pa ujitje janë shumë të rrezikuara nga dëmtuesit e drurit, trungjeve dhe degëve, sepse këto insekte kërkojnë pemë me pak lëngje në trupin e tyre. Kujtojmë insektet e mobiljeve, të cilët pëlqejnë drurë pa lagështirë. Limfa e

(Vijon në faqen 12)




**KËNDI I MBROJTJES INTELEGJENTE TË BIMËVE**

(Vijon nga faqja 10)

# Praktikat agronomike, si masa parandaluese të dëmtimeve të bimëve nga insektet, sëmundjet dhe barërat e egra

bollshme në trupin e bimës nuk u krijon kushte të mira aparatit brejtës të këtij grupi insektesh. Raste të tilla ku kumbullat e



mbjella në kodër janë dëmtuar rëndë, kemi pasur dhe kemi në çdo zonë të vendit.

Vendi i mbjelljes lidhet edhe me reaktionin e tokës, përbindjen e kripëzimit dhe strukturën e tokës. Pra duhet të njihen kërkesat e bimëve dhe pikat e tyre të dobëta, para se ato t'i mbjellim në tokë me farë ose fidana. Në vendin tonë janë mbjellë ullishte në zonat fushore me ujëra nëntoksore afër rrenjëve, ose në tokat me kripëzim mbi normë. Ullishtet kërkojnë toka të kulluara mirë dhe toka të shtrira në masive kodrinore. Ka edhe fusha me kullim të sigurtë, ku edhe ulliri mund të mbillet. Bimët e mbjella në kushte toksore të papërshtatshme shfaqin shenja që duken si shenja sëmundjesh, duke na dhënë informacion të gabuar, nëse nuk thellohemi fillimisht në parametrat toksorë.

**• Përzgjedhja e farës dhe fidanit cilësor**

Ndaj farës ka disa kërkesa: të jetë e pastër nga infeksionet nga dëmtuesit dhe sëmundjet, fara duhet të ketë fuqi dhe energji mbirëse mbi 95%. Të jetë farë e gjeneratës së parë (F1) sidomos kjo për bimët e arave. Në rastin e fidanave ka rëndësi të kontrollohet sistemi rrënjor dhe forma e kurorës, e cila do të jetë pemë e ardhëshme. Në rashte të tilla duhen respektuar standardet e cilësisë, të cilat janë të shkuara dhe të miratuara.

**• Përzgjedhja e kultivarit, sipas zonës dhe tokës**

Ndaj kultivarëve që përzgjedhim duhet të kemi parasysh: Si shkon ai me tokën dhe zonën përkatëse, sa rezistent ose i durueshëm është ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesëve kryesorë, sa rezistent është ndaj thatësisë

etj. Në vendin tonë janë mbjellë kultivarë ulliri Kalinjot në zonën e Shqipërisë së Mesme, i cili nuk rritet mirë në këtë zonë.

Ullishtet nuk kanë kushte të sigurta klimaterike kur ato janë mbjellë shumë në veri të vendit, psh në Malësinë e Madhe. Ka vite kur në këto zona temperaturat bien minus 5-7°C, kushte kur ullishtet dëmtohen fizikisht.

**• Qarkullimi bujqësor brenda vitit dhe nga viti në vit**

Me qarkullimi bujqësor kuptojmë kur në një parcelë nga njëri vit në tjetrin mbjellim specie të ndryshme bimësh me largësi familjare botanike.

Qarkullimi bazohet në përdorimin e vlerave biologjike të një bime paraardhëse nga bima pasardhëse.

Bimët e ndryshme kanë kërkesa të ndryshme për lëndë ushqyese. Një pjesë konsumojnë më shumë azotin disa më shumë fosforin, disa konsumojnë më shumë potasin. Rezervat që mbeten në tokë pa u shfrytëzuar nga bima paraardhëse, i përdor bima pasardhëse. Bimët e ndryshme preken nga sëmundjet dhe insekte të ndryshme dhe bima pasardhëse gjëjnë rezervë të pakët parazitësh në parcelën përkatëse.

Tabela e mëposhtme ilustron vlerat e qarkullimit bujqësor në shmangien e parazitëve të misrit të mbjellë pas grurit dhe rreziku i shtuar i mbjelljes së grurit pas grurit.

Grurë, 2023 (Parcela Nr. 1)	Grurë 2024 (Parcela Nr. 1)	Misër 2025 (Parcela Nr. 1)
Parazitët që e prekin	Mundësia e prekjës	Mundësia e prekjës
Afidet (morrat)	Po	Po
Çimkat	Po	Jo
Shushunja gjetheve (Lema melanopus)	Po	Jo
Dëmtuesit e tokës	Po	Po
Kalbëzimi rrënjëve	Po	Jo
Hiri	Po	Jo
Septerioza	Po	Jo
Bloza grurit	Po	Jo
Urthi në grurë	Po	Jo
Barërat e egra	Po	Pjesërisht

Tabela argumenton se kur bima e grurit mbillet në të njëjtën parcelë (në rastin tonë në parcelën Nr.1), bimën e grurit në vitin e dytë, 2024 e presin të njëjtat probleme fitosanitare si në vitin 2023.

Kur kjo parcelë në vitin 2024 mbillet me misër, kjo e fundit për vitin 2025 lirohet shumë nga problemet fitosanitare, sepse shumica e parazitëve të grurit nuk e prekin misrin.

E njëta situatë shfaqet kur mbjellim domate pas domateje, kastravec pas kastravecit, sepse sëmundjet të tilla si ato që vijnë nga toka, nematodat, insektet minuese të gjetheve, krahbardha serrave etj., do jenë të pranishme edhe në vitin pasardhës. Respektimi i qarkullimit bujqësor, gjithnjë e më tepër, madje në gjitha sistemet bujqësisë, nuk lihet në dëshirën e fermerëve, por ka udhëzues teknikë, të cilat i detyrojnë fermerët të zbatojnë skemat e qarkullimit bujqësor. Nëse një fermer ngarkon parcelat e tij me infeksione të larta nga sëmundjet dhe dëm-

tuesit, kjo ka pasoja edhe për fermerët e tjerë, sidomos për ato fqinjë. Bujqësia biologjike e ka zgjidhur këtë praktikë agronomike me standardin e saj, i cili parashikon që fermat bio duhet të paraqesin para inspektorëve zbatimin e skemës së qarkullimit bujqësor.



**• Mbrojtja mekanike**

Mbrojtja mekanike përfshin atë bazë materiale që pengon hyrjen e insekteve dhe brejtësve në parcelat e mbjella, ose në magazinat e prodhimit.

Të tilla materiale janë rrjetat që mbulojnë serrat ose parcelat në fushë.

Mbyllja e mirë e magazinave për të penguar futjen e

minjve. Mbështjella e pemëve të reja me rrjeta plastike për të menjanuar ngrënien e lëkurës së tyre nga brejtës si lepurt, pengesa prej dërrase ose kanale të vegjël për të penguar futjen e kërmijve në parcela.

**• Mbrojtja legislative**

Kjo masë mbrojtëse përfshin ligjet dhe rregulloret, të cilat lidhen me karantinën e brendshme dhe të jashtme të sëmundjeve dhe dëmtuesve, të cilët nuk gjenden në zona të tjera të vendit, ose nuk gjenden fare në Shqipëri. Njëzet vitet e fundit në tashmë kemi dy dëmtues të rrezikshëm, të cilët nuk i kishim më parë; tenjën e perimeve (Tuta absoluta) dhe mizën Mesdhetare (Ceratitis capitata) në hurma, agrume, pjeshkë etj. Këto dy dëmtues kanë ardhur në vendin tonë nëpërmejt mjeteve të transportit të fruta-perimeve dhe nga vetë produktet e infektuara nga këto dy dëmtues.

Infeksionet nga një zonë në një tjetër mund të shpërndahen edhe nga fidanishtet e pemëve dhe perimeve. Në këto mjedise duhet të ketë kontroll të fortë, sepse shumë sëmundje të rrezikshme si zjarri bakterial (Erwinia amylovora) në mollë e dardhë dhe kancerat bakteriale në ullinj dhe hardhi, shpesh vijnë nga fidanishtet. Fidanat e pemëve duhen kontrolluar edhe nga infeksionet nga breshkëzat. Nga vendet ku prodhohen fidanat e perimeve kërkohet higjenë e lartë, sepse që këtu mund të vijnë infeksionet nga tenja e perimeve, tuta absolute, krahëbardha, këpusha e perimeve etj.

**“KËNDI I POEZISË SË BLERTË”**

**Personalitetet e Bujqësisë**

**ABEDIN ÇIÇI**

(Frutikulturisti legjendar. Ndërroi jetë në moshën 94 vjeç)

**I**

Bujqësia jonë e dashur  
Pati fat të pamatë  
Legjendari Abedin Çiçi  
Punoj shumë dhe jetoj gjatë.

**II**

Ai jetoj tre epoka  
Dhe i dha kaq shumë atdheut  
si nga trupi dhe nga koka.  
Agronom Abedin Çiçi  
E filloi çdo gjë nga hiçi  
Që nga fara dhe fidani  
Deri sa u gjelbërua gjithë vatani.

**III**

Punoj si milingonë  
Punoj si mizë blete  
Ishte një model i rrallë  
Ishte institut më vete.

**IV**

Patriot i papërshkruar  
Shkencëtar i pasionuar  
Rrugëtar i papërtuar  
Njerëz për të takuar

Pa pushim për t'i mësuar

Tokën për ta gjelbëruar  
Sa më shumë për të prodhuar.

**V**

Zemra jonë do të qetësohet  
Kur vepra dhe jeta e Tij  
e gjitha do të digjitalizohet  
Kur rinia ta klikojë  
Veprën tuaj, o patriot  
Krenarë do të ndihen brezat  
mendje kthjellët e xhepin plot.

**PRODHIM VENDI**

Të gjithë shqiptarët kërkojnë prodhim vendi  
Duan të ushqehen me ushqim vendi  
Duan të këndojnë e dëgjojnë këngë vendi  
Duan të shikojnë filma vendi  
Duan të qeshin e kënaqen me humor vendi  
Duan të shikojnë sporte vendi  
Duan të kërcëjnë valle vendi  
Prodhimet e vendit të huajt me duart tona,  
na i shkullen që nga themelet  
Ndaj shqiptarët po lenë Shqipërinë  
Nuk e dimë  
Sa e vogël Shqipëria do të ngelet  
Nga askush nuk duhet pritur  
Shqiptarët, vetë do ta bëjnë Shqipërinë  
Më të bukur, më të madhe më të ditur.


Enver Isufi

**BLETA DHE KRIMBI I SHIUT**

Sjelljen e njeriut mbi tokë  
E certifikon Bleta  
Për nëntokën, sjelljen e njeriut  
E certifikon Krimbi i Shiut  
Nëse këto gjallesa të mrekullueshme  
Janë të lumtura dhe jetojnë në normalitet  
I lumtur do të jetë çdo njeri e çdo komunitet  
Certifikata e lëshuar,  
prej Krimbit të Shiut dhe Bletës  
Është certifikata e së vërtetës.  
Njeriu botën e ka dixhitalizuar  
Por mrekullitë e Bletës dhe të Krimbit të Shiut,  
ende nuk i ka realizuar  
“Certifikata e vërtetë e Njeriut”  
Është certifikata firmosur dhe vulosur  
Nga Bleta dhe Krimbi i Shiut.

**KALI**

Kali ishte tanku i parë  
Kali ishte traktori parë  
Kali ishte makina e parë  
Edhe makinat e sotme moderne  
Me goma dhe shasi  
Kalin që vrapon në çdo terren  
e kanë shumë zili  
Nuk përdor naftën e nxjerrë në thellësi  
Veç bar dhe tagji, përdor për energji  
Kalin e mban në shtëpi çdo njeri i thjeshtë,  
E përdor çdo punëtor  
Kali është i pranishëm në çdo oborr  
mbretëror  
Kjo kafshë simpatike  
Një makinë biologjike  
A nuk shikojmë në sheshet e botës  
Mbretër, princër e gjeneralë  
Janë derdhur në bronx  
Pikërisht mbi kalë?



KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji janar 2024

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

sisht 8 deri në 15 ditë shi. Gjatë muajit janar në Tiranë, mundësia e një dite vetëm me shi do të mbetet në thelb konstante 27% gjatë gjithë kohës, mundësia e

Pamja e qiellit gjatë muajit janar 2024

Më 3, 4 janar - Dush meteorësh Quadrantidësh. Quadrantids është një shi mbi me-

Parashikimi i motit për muajin janar 2024 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C (U, L), Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli.

Parashikimi i motit për janar 2024 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C (U, L), Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli.

sataren, me deri në 40 meteorë në orë në kulmin e tij. Mendohet se prodhohet nga kokrrat e pluhurit të lënë pas nga një kometë e zhdukur e njohur si 2003 EH1, e cila u zbulua në vitin 2003. Dushi fillon çdo vit nga 1-5 janari. Kulmin e ka këtë vit natën e datës 3 dhe mëngjesin e datës 4 janar. Hëna gjigande në rënie do të bllokojë disa nga meteorët më të zbehtë, por nëse jeni të durueshëm, kjo mund të jetë ende një shfaqje e mirë. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend i errët pas mesnate. Meteorët do të rrezatojnë nga yjësia e Çizmeve, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Më 11 janar - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 11:59 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objektet e zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Më 12 janar - Mërkuri në zgjatjen më të madhe perëndimore. Planeti Mërkuri do të arrijë zgjatjen më të madhe perëndimore prej 23.5 gradë nga Dielli. Kjo është koha më e mirë për të parë Mërkurin pasi ai do të jetë në pikën e tij më të lartë mbi horizont në qiellin e mëngjesit. Kërkoni planetin poshtë në qiellin lindor pak para lindjes së diellit.

Më 25 janar - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 17:55 UTC. Kjo hënë e plotë njihet nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e Ujkut, sepse kjo ishte koha e vitit kur tufat e ujërve të uritur ulërinin jashtë kampeve të

Treguesit mesatare klimatike gjatë muajit janar 2024

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. Rows include temperature, precipitation, wind speed, etc.

tyre. Kjo hënë ka qënë e njohur edhe si Hëna e Vjetër dhe Hëna Pas Krishtlindjeve.

Parashikimi i motit për muajin janar 2024

Muaji janar në Tiranë do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Moti në Shqipëri në janar do të jetë shumë i ftohtë me temperatura ndërmjet 3°C dhe 10°C. Në Tiranë në janar mund të prisni: pothuajse çdo ditë reshje shiu, kohë pas kohe stuhi, herë pas here mjegull, rrallë borë dhe mot më i freskët. Gama e temperaturave mesatare ditës do të jetë rreth 11°C. Tirana në janar do të përjetojë ditë të freskëta me qiell me vranësira të forta. Zakonisht temperatura do të luhet rreth 13°C dhe do të ndihet për 11°C dhe era do të jetë fllad i lehtë. Temperaturat e larta ditore do të jenë rreth 11°C, rrallë do të bien nën 7°C ose të kalojnë 16°C. Temperatura më e ulët mesatare e lartë ditore do të jetë 11°C më 15 janar. Temperaturat e ulëta ditore

do të jenë rreth 1°C, rrallë do të bien nën -5°C ose do të kalojnë 6°C. Temperatura më e ulët mesatare ditore do të jetë 0°C më 4 janar.

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18°C në 32°C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0°C në 11°C.

Zhvillimi i reve

Muaji janar në Tiranë, do të përjetojë në thelb mbulim të vazhdueshëm me re, me përçindjen e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht vranësira do të mbetet rreth 51% gjatë gjithë muajit. Mundësia më e ulët e kushteve me vranësira ose kryesisht vranësira do të jetë 50% më 2 janar.

Dita më e kthjellët e muajit do të jetë është 2 janari, me kushte të kthjellëta, kryesisht të kthjellëta ose pjesërisht me vranësira në 50% të rasteve.

Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit, shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin janar 2024

Table with columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %, Dita), Shënjat Astrologjike.

55%, ndërsa më 21 korrik, dita më e qartë e vitit, mundësia e qiellit të pastër, është 91%.

Zgjatja e ditës

Gjatë muajit janar në Tiranë, zgjatja e ditës do të rritet. Nga fillimi deri në fund të muajit, kohëzgjatja e ditës do të rritet me 47 minuta, duke nënkuptuar një rritje mesatare ditore prej 1 minutë e 33 sekonda dhe një rritje javore prej 10 minuta e 54 sekonda. Dita më e shkurtër e muajit do të jetë 1 janari me 9 orë e 15 minuta ditë dhe dita më e gjatë do të jetë 31 janari me 10 orë e 2 minuta ditë.

Agimi më i vonë i muajit në Tiranë, do të jetë në ora 7:06 e mëngjesit të 4 janarit dhe lindja më e hershme do të jetë 13

minuta më herët në orën 6:53 të mëngjesit të 31 janarit. Perëndimi më i hershëm i diellit do të jetë në ora 16:21 më 1 janar dhe perëndimi më i vonshëm i diellit do të jetë 33 minuta më vonë në 16:55 më 31 janar.

Për referencë, më 21 qershor, dita më e gjatë e vitit, Dielli lind në orën 5:07 të mëngjesit dhe perëndon 15 orë dhe 10 minuta më vonë, në orën 20:17, ndërsa më 22 dhjetor, dita më e shkurtër e vitit, dielli lind në orën 7:03 të mëngjesit dhe perëndon 9 orë e 11 minuta më vonë, në orën 16:14.

Reshjet

Në Shqipëri mund të presësh reshje shiu afërsisht në gjysmën e muajit janar. Ne presim afër-

një dite me borë dhe shi të përzier do të mbetet në thelb 1% konstante gjatë gjithë kohës dhe mundësia e një dite me vetëm bora do të mbetet në thelb konstante 0% gjatë gjithë kohës.

Për referencë, mundësia më e lartë ditore e vitit për një ditë të lagësht është 36% më 5 dhjetor dhe shansi më i ulët i tij është 10% më 7 korrik.

Mesatarja e akumulimit të reshjeve 31-ditore gjatë janarit në Tiranë, do të mbetet konstante duke mbetur rreth 70 milimetra, kur rrallë i kalon 130 milimetra ose bie nën 10 milimetra. Akumulimi mesatar më i ulët 31-ditor do të jetë





Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe  
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,  
BËHET!*



 **CREDINS bank**

[www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com)

Tel.: +355 4 53 53 000

